



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 49.
Prishtinë, më 11.09.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, , Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Elmi Reçica dhe Glauk Konjufca

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB, Lejla Selimi, përfaqësuese nga zyra e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues nga zyra e KKK Veton Berisha, përfaqësues nga zyra e Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara**
- 3. Shqyrtimi i Projektregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës , me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente**
- 4. Formimi i Grupit të punës për vizitë Komunitetit Rome, Ashkalinjë dhe Egjiptian në Mitrovicë, sipas pikave 144 dhe 142 sipas Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryesuesi – në fjalinë e tij tha se Komisionit iu është ofruar ofertat për asistencë nga OSBE, në sferën e mbikëqyrjes së shpenzimeve për Ministrin për Komunitete dhe Kthim dhe agjencitë nën mbikëqyrjen e saj

Kryesuesi - konstatoi se komisioni, miratoi rendin e ditës me këtë plotësim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi -konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 24.08.2012, 27.08.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës , me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente

Kryesuesi, - theksoi se në bazë të procedurave të parashikuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit është detyrë dhe përgjegjësi e komisionit që të shqyrtohet Rekomandimi i Projektregullorës së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ai propozoi që amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, të votohen veçmas dhe pas vlerësimit të tërësishëm komisioni do të nxjerr rekomandime, dhe i njëjti do t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit Funkcional.

Në këtë drejtim hapi debat, nëse ka propozime në amendamentet e komisionit funksional.

Jasmina Zivkovic - sa i përket Projektregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës ajo shprehu qëndrimin e saj se amendamenti 25 dhe 26 , paraqet shkelje të të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe se të njëjtat kanë të bëjnë me procedurën e ndryshimeve Kushtetuese, Ishte e mendimit që komisioni të mos përkrah amendamentin e lartcekura, të propozuara në draftin e komisionit Funkcional, ku të njëjtat kanë të bëjë me procedurën e ndryshimeve Kushtetuese në nenet 69 dhe 70 .

Propozimi i saj ishte që nenet të mbeten sipas Projektregullorës e cila është në fuqi.

Mufera Sinik – tha se ka qen anëtare e Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore te Punës dhe gjatë amandamentimit të Projektregullores është marr qëndrim që neni 69 dhe 70 të mbetet si në propozim të draft rregullores, andaj nuk ka njohuri për ndryshimet e bëra nga komisioni për Legjislacion.

Në kuadër të kësaj çështje, ajo dhe Albert Kinolli janë të mendimit që nenet e lartcekura të mbeten siç janë propozuar në draft Projektregullore.

Kryesuesi, - konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur më 11.09.2012, shqyrtoi Projektregullorë e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës me amendamente të propozuara nga komisioni Funkcional për legjislacion, dhe pas vlerësimit të tërësishëm, vendosi që Komisionit t ia paraqesë këtë;

R e k o m a n d i m

- I. Projektregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk i shkelë dhe nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II: A – Komisioni shqyrtoi amendamentet e propozuara të Komisionit funksional për legjislacion dhe i miratoi amendamentet 4, 5, 9, 12 13, 15, 16, 19, 21, 23, 24, 27, 31 dhe 32, ndërsa amendamentet 25 dhe 26 nuk i miratoi.
B – Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga Grupi i grave dhe të njëjtat nuk i miratoi.
C - Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga deputetja Alma Lama dhe miratoi amendamentin 18, ndërsa amendamentet 10, 14, 17, 20, 22 dhe 28 nuk i miratoi.

D - Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara të anëtares së komisionit ad-hoc, Albulena Haxhiu dhe të njëjtat nuk i miratoi.

- III. Në bazë të konstatimeve të sipërsënuara, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Arsyetim

Komisioni shqyrtoi amendamentet e propozuara të Komisionit funksional për legjislacion dhe njëzëri miratoi amendamentet 4, 5, 9, 12, 13, 15, 16, 19, 21, 23, 24, 27, 31 dhe 32, ndërsa me vota dy për, të një rezervuar dhe shtatë kundër, nuk i miratoi amendamentet 25 dhe 26. Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga Grupi i grave ku me vota tri për dhe shtatë kundër, të njëjtat nuk i miratoi.

Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara të anëtares së komisionit ad-hoc, Albulena Haxhiu dhe të njëjtat nuk i miratoi.

Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga deputetja Alma Lama dhe miratoi njëzëri amendamentin 18, ndërsa amendamentet 10, 14, 17, 20, 22 dhe 28 nuk kanë marrë përkrahjen e komisionit.

4. Formimi i Grupit të punës për vizitë Komunitetit Rome, Ashkalinj dhe Egjiptian në Mitrovicë, sipas pikave 144 dhe 142 sipas Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012

Kryesuesi – me theks të veçantë tha se për realizimin e Planit të Veprimit për tremujorin e dytë 2012, si sfida e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka mbetur realizimi i vizitës në terren të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, në zonën e Mitrovicës ku në këtë zonë niveli i kontaminimit me plumb është i lartë.

Ai propozoi se për realizim të vizitës të formohet grupi punues, i cili për së afërmi do të vëzhgojë gjendjen shëndetësore të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Gjithashtu propozoi që nga Ministria e Shëndetësisë të kërkohet Raportin i gjendjes shëndetësore të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Mitrovicës, në zonën e kontaminuar me plumb.

Në kuadër të realizimit të vizitës, komisioni në mbledhjen e ardhme do të dalë me raport të detajuar për situatën shëndetësore të këtyre komuniteteve.

Lirije Kajtazi – pajtohet të formohet grupi punues, ku do të vëzhgohet për së afërmi gjendja reale e secilës bashkësi, Ajo propozoi si anëtare e grupit punues, Jasmina Zivkovic .

Mufera Sinik - Ishte e mendimit që vizita në zonën e Mitrovicë të organizohet në përbërje të plotë të anëtarëve të komisionit.

Petar Miletic – ishte i mendimit se grupi punues të njoftojë anëtarët e komisionit dhe në harmoni me agjendën parlamentar do të marrin pjesë në këtë vizitë.

Albert Kinolli, tha se në komisioni duhet të jetë unik dhe homogjen siç ka funksionuar edhe në situatat tjera, Ishte i mendimit që të formohet grupi punues, dhe ftesës ti përgjigjemi pozitivisht në vizitën që do të bëhet në zonën e Mitrovicës.

Më herët është kërkuar një raport zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe kërkesa e tij ishte që paraprakisht të kemi këtë raport ku do të bëhen krahasime lidhur me situatën në terren.

Në bazë të vlerësimeve të përgjithshme komisioni do të dalë me raport të detajuar.

Ai propozoi që në grup punues të jetë edhe një përfaqësues i komunitetit shumicë.

Xhevdet Neziraj – Në fjalinë e tij tha se sa i përket realizimit të vizitës duhet të jetë e planifikuar dhe organizuar mirë. Sa i përket grupit punues mundë të vlerësojë vetëm anën ekonomike, si jeton ky komunitet. Duhet të ndërmerren veprime konkrete nga se nuk mund të dilet me pasqyrë

krahasuese, në cilën masë është i helmuar gjaku i komitetit Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian, Propozimi i tij ishte që gjatë vizitës të jenë prezent edhe përfaqësuesit e ministrisë resor, të cilët do të vlerësojnë gjendja reale të këtyre komuniteteve.

Gjithashtu kërkoi që paraprakisht të marrim raportin me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë, ku këtë nismë e mbështesin obligimet dhe analizat lidhur me gjendjen shëndetësore të qytetarëve të cilët jetojnë në kampin e zonës së Mitrovicës.

Pas realizimit të vizitës, Komisioni do të dalë me rekomandime konkrete, të cilat do të realizohen në praktikë.

Lumnije Morina – Plotësisht pajtohet me diskutimin e z. Xhevdet, se nuk jemi profesionalist për të vlerësuar përqindjen me plumb në gjakun e komunitetit në fjalë. Ajo propozoi që grupit punues t’ju bashkëngjitet një ekip profesionaliste që të bëhen vlerësimet e duhura dhe më pas do të dalim me raport me të dhëna konkrete dhe të sakta.

Gjithashtu, pajtohet të kemi raportin e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me gjendjen shëndetësore të këtyre qytetarëve.

Në vizitën e cila do ti bëhet komuniteteve të cilët jetojnë në zonën e Mitrovicë, ajo deklarohej si anëtare e grupit punues.

Kryesuesi – plotësisht pajtohet me propozimet e parafolësve dhe sugjeroi që grupit punues t’ju bashkëngjitet ekipi i mjekësisë ligjore në kuadër të Ministrisë resurse, për të marrë mostra të gjakut të këtyre komuniteteve Posaçërisht, në raport do të paraqiten vlerësimet konkrete lidhur me kontaminimin e zonës së Mitrovicës.

Petar Miletic- në fjalinë e tij tha se ka njohuri që ekziston raporti me analiza për nivelin e plumbit në gjakun e komunitetit në fjalë, mes tjerash tha se janë bërë analizat nga ekspertët e KFOR-it. Ai kërkoi që komisioni të ketë raportin e Ministrisë së Shëndetësisë ku do të kemi gjendjen reale të komunitetit Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, emërtoi grupin punues, në këtë përbërje:

Albert Kinolli, Xhevdet Neziraj, Mufera Sinik, Jasmina Zivkovic dhe Lumnije Morina.

5. Të ndryshme.

Kryesuesi- e njoftoi komisionin, paraprakisht ka pas takim me ushtruesin e detyrës së drejtorit të OSB-së Jeard Hays dhe zyrtarët tjerë, të cilët janë të interesuar të ofrojnë ndihmë lidhur me projektin për mbikëqyrjen financiare të ndonjë sektori brenda ndonjëre prej ministrive, apo agjencive përkatëse që i përket sferës tonë. Për iniciativën e këtij projekti, më detajisht do të na njofton Shpend Qamili.

Shpend Qamili – zyrtar i OSB-së, theksoi se organizata e OSB-së ka bërë ftesë për bashkëpunim me Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me temën: Mbikëqyrja financiare e shpenzimeve të resorit të caktuar, që mbulon ky komision.

Sa i përket procedurave, diskutimi nuk mund të kufizohet për revizionin e auditimit sepse këtë e kryen auditori, furnizimi bëhet nga agjensionet përkatëse, Gjegjësisht, qëllimi kryesor i Komisionit është mbikëqyrja financiare e resorëve, kontrollimi i resorëve se si menaxhohet buxheti i tyre, etj.

Vlerëson mundësin, se Komisioni është ai i cili do të vendos për cilin Ministri apo agjension do të përcaktohet, posaçërisht ku parasheh se është parësore të bëhet mbikëqyrja financiare.

Theksoi se do të vihen në mbështetje nga ana jonë ofrimi i dokumenteve të nevojshme ku bashkërisht do të përpilojmë agjendën, pyetjet për debat, lista e dëshmitarëve.

Në kuadër të punës gjithëpërfshirëse, në bashkëpunim me komisionin do të përpilohet raporti i cili do të prezantohet si raport i mbikëqyrjes financiare

Petar Miletic- në fjalinë e tij tha se detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë kontrollimi i ekzekutivit, mbikëqyra e Ministrive në anën e respektimit të të drejtave të komuniteteve.

Ajo që konsiderohet mjaft e rëndësishme është se propozimi i partnerëve mund të paraqet ndërhyrje të kompetencave të auditorit, në ministri andaj nuk e sheh të arsyeshme të jemi mekanizma kryesor për kontrollimin e ministrive, nga se nuk jemi ekspert financiar.

Pyetja për partnerët ishte se në bazë të këtij projekti, detyrë e komisionit do të jetë synimi i mbikëqyrjes së zbatimit të buxhetit në ndonjë ministrie apo edhe punët tjera.

Xhevdet Neziraj - tha se përveç që është anëtar i këtij komisioni njëherit është anëtar edhe në komisionin për buxhet dhe financa.

Ai dha sqarim lidhur me përgjegjësit dhe detyrat e komisionit për buxhet, para hartimit të Buxhetit organizohen dëgjime buxhetore të bazuara në raportet e ministrive ku më pas i njëjti shqyrtohen në komisionin dhe në bazë të prioritetëve, vendoset linja e tyre financiare.

Në kuadër të aktiviteteve, Komisioni për komunitete i realizon kompetencat e saja të bazuara në Rregulloren e punës, si gjatë shqyrtimit të projektligjeve në parim, po ashtu mbikëqyrjen e implementimit të ligjeve nga ana e dispozitave në respektimin e të drejtave dhe interesat e komuniteteve.

Pyetja e tij ishte, se paraprakisht misioni i juaj do të sjell projektin me program për mbikëqyrjen financiare të ndonjë ministrie, si menaxhohen mjetet buxhetore.

Albert Kinolli – tha se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me anë të komisioneve përkatëse ka mekanizma e saja në mbikëqyrjen e çështjeve financiare të njërive buxhetore në ministrinë përkatëse. Si anëtarë edhe i komisionit për mbikëqyrje të financave publike, tha se në këtë komision shqyrtohen të gjitha raportet e auditorit gjeneral. Në rastet kur vlerësohet se ka shkelje apo parregullsi, ky komision ka kompetenca që të njëjtat ti drejtojë në instancat më të larta.

Mendon se në bazë të projektit të OSB-së, në vlerësimet buxhetore të një resori mund të krijohen mekanizma paralele, nga se krahas raporteve të komisioneve përgjegjëse, Komisionit për buxhet dhe komisionit për mbikëqyrje të financave publike, mund të bie në kundërshtim me raportin cili do të dalë nga komisioni jonë

Rasim Demiri –kur bëhet fjalë për shpërndarjen e mjeteve financiare, diskutoi se Ministria e Bujqësisë ka pas grande nga shpenzimet buxhetore, ku janë paraqit 24 aplikues ndërsa nuk jemi të informuar a janë ndarë edhe për komunitetin boshnjak Ai shtoi se edhe investimet tjera kapitale nuk ndahen proporcionalisht për komunitetin pakicë.

Lirije Kajtazi – pajtohet me diskutimin e parafolësve duke konstatuar se kompetent nuk i takojnë vetëm një institucion, duhet të caktohen në bashkëpunim me zyrën pran kryeministritë, Ministrinë e financave, institucionet në nivele lokale.

Propozimi i saj ishte që të bëhet projektimi i shpenzimeve buxhetore, si nga vija institucionale ashtu edhe nga përfitimet e shumta, nga donacionet.

Lumnije Morina- sa i përket temës për kontrollimin e financave të ministrive, ajo tha se fillimisht askush nuk na ndalon të formohen grupe punuese dhe të bëhet kontrolli i ndonjë ministrie.

Mirëpo nuk e sheh të arsyeshme të jemi si ndërmjetësues që të bëhet kontrolli i granteve në Ministrinë e Bujqësisë, nga se kompetencat i menaxhon vetë ministria.

Andaj kërkoi të sqarohet roli i OSB-së, lidhur me temën mbikëqyrja e zbatimit të buxhetit nga komisioni janë.

Jelena Bontic- në fjalinë e saj tha nuk e sheh si çështje pozitive temën e cila po diskutohet, nga se nuk është e logjikshme të përzihemi në punën e institucioneve tjera. Komisioni janë orientohet në shqyrtimin e projektligjeve në parim, mbikëqyrja e tyre.

Jared Hays -Ushtues i detyrës së Drejtorit pran zyrës së OSB-së tha se misioni i OSB-së, është i mandatar përmes tjerash, të përkrah Komisionet Parlamentare të Kuvendit të Kosovës.

Sa i përket mbikëqyrjes financiare kjo çështje qartë rrjedh në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës dhe se nuk është detyrë vetëm e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, por është detyrë edhe të komisioneve tjera.

Mbikëqyrja financiare e komisionit tuaj është ndryshe nga auditori i përgjithshëm dhe komisionet e lartë cekura.

Si detyrë e komisioni për komunitete mund të jetë orientimi në raportet e auditorit të përgjithshëm, mund të mbikëqyrret ndarja proporcionale e grave të Ministrisë së Bujqësisë, të ftohen menaxherët e projekteve të agjencive, etj

Në fund, në bashkëpunim dhe bashkëveprim do të hartohet raporti me rekomandime, në fushën e mbikëqyrjes së zbatimit të buxhetit në resorin përkatës.

Petar Miletic - tha se në kuadër të temës së caktuar, nëse mbikëqyrjes financiare nuk do të paraqet dyfishim të kompetencave atëherë është pro të formohet grupi punues për fillimin e mbikëqyrjes financiare në një resori të caktuar.

Kryesuesi – Ne bazë të diskutimeve të anëtarëve dhe shpjegimeve të përfaqësuesit të OSB-së , Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim , nxori këtë:

Përfundim

Formohet grupi punues në përbërje: kryetar i grupit punues, Petar Miletic ndërsa anëtarët tjerë, Mufera Sinik, Jelena Bontic dhe Xhevdet Neziraj.

Mbikëqyrja financiare e komisioneve Parlamentare me përkrahjen e përfaqësuesve të Misionit të OSB-së.

Korniza kohore për fillimin e punës do të caktohet me marrëveshjen e anëtarëve të grupit punues dhe stafit të OSB-së

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic